



Bordi
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

VENDIM

Nr. 192, Datë 24.11.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR
NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR”**

Në mbështetje të neneve 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 76 të ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016”; Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 24.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e ”draft– Rregullores për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror”, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike.

Konstatoi se:

Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 76 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, ERE miraton rregulloren për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të Fillojë procedurën për miratimin e rregullores për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi, mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi

Votimi i Antarëve të Bordit të ERE, për

VENDIMIN

Nr. 192, Datë 24.11.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR
NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR**

Antarët e Bordit

| | Pro | Kundër |
|----------------------|-------|--------|
| Petrit Ahmeti | _____ | _____ |
| Adriatik Bego | _____ | _____ |
| Abaz Aliko | _____ | _____ |
| Entela Shehaj | _____ | _____ |
| Maksim Shuli | _____ | _____ |